



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.282/2018

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari Individual Faton Ademi, ne çështjen juridike te paditëses: nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. nga Mitrovica, kundër të paditurës:

, për shkak të kompensimit të të ardhurave në emer të shpërblimit jubilar dhe kompensimin në emër të pagave përcjellëse në pension, pas mbajtjes se seancës kryesore publike, me dt. 01.11.2018, nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**OBLIGOHET** e paditura ..... që t'ia paguajë paditëses ..... nga Mitrovica, në emër te pagesës së 3 pagave për shpërblim jubilar pas pensionimit dhe 3 pagave përcjellëse për periudhën e punës prej 44 vite, e 5 muaj, e 15 ditë shumën totale prej 2,651.20 €, me kamat ligjore prej 8% nga dita e ngritjes se padis e deri ne pagesën definitive, te gjitha ne afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit te aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**OBLIGOHET** e paditura ..... t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 104 euro për përpilimin e padisë, 40 euro për taksë gjyqësore nga 135 euro për përfaqësim në seancë, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

**A r s y e t i m**

Paditësja me datën 26.04.2018 ka ushtruar padi për kompensimin e të ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te shpërblimit jubilar 3 paga dhe në emër te 3 pagave përcjellëse për në pension.

Gjykata, me dt. 17.10.2018, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditëses, për të paditurën askush, është ftuar me rregull ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar.

I autorizuari i paditëses i ka propozuar gjykatës që të mbahet seanca në mungesë se të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt, gjykata e ka aprovuar propozimin e të autorizuarit të paditëses.

I autorizuari i paditëses në seancën dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paraqitur me shkrim, ku me vërtetimin e lëshuar nga SHFMU Migjeni vërtetohet se paditësja posedon përvojën e punës prej 44 vite, e 5 muaj, dhe 15 ditë, ndërsa nga pasqyra financiare vërtetohet se paditësja për muajin Shkurt 2015 ka marrë pagë prej 424.13, për Mars 424.13, ndërsa për Prill 477.34, ku në zbatim të nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive në emër të tri pagave jubilarë dhe 3 pagave përcjellëse arrin lartësia e kërkesëpadisë në shumë prej 2,651.20 €, si dhe shpenzimet procedurale në emerë të takësës për padi në vlerë prej 40 euro, në emerë të përpilimit të padisë shumë prej 104 euro dhe për qdo përfaqësim nga 135.20 euro.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 të LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Kopja e lejes së njoftimit të paditëses, vendimi i dt.12.04.2018, kontrata e punës e dt.10.09.2012, shkresa e dt.23.04.2018, qarkullimi bankar për periudhën 01.02.2015-01.06.2015, vërtetimi i dt.25.06.2018, ku pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Fillimisht paditësja para ngritjes së padisë ju ka drejtuar të paditurës me kërkesë të dt. 18.04.2018 për kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse pas pensionimit, ndërsa e paditura me datë 23.4.2018 e ka njoftuar paditësen se sipas Ligjit të Punës nuk janë paraparë kompensime të tilla, ndërsa dispozitat e Kontratës Kolektive nuk janë obligative për punëdhënësin, kjo vërtetohet nga përgjigja në kërkesë e dt.23.04.2018.

Nuk është kontestues fakti që paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura nga datat: 25.11.1970 deri me 10.05.2015, ky fakt vërtetohet në bazë të vërtetimit nr.3/2018 të datës 25.04.2018.

Nga vërtetimi nr. 3/2018 të datës 25.04.2018 vërtetohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në shkollën e mesme të ultë " Migjeni".

Me vendimi e dt.12.04.2018 e nxjerr nga e paditura, vërtetohet se paditëses i ka pushuar marrëdhëniet e punës për shkak të pensionit të pleqërisë me dt.10.05.2015.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës mesatare neto që paditësja e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 441.86 €. Ku në bazë të gjendjes së llogarisë për muajin Shkurt 2015 paditësja ka realizuar pagë mujore prej 424.13, për muajin Mars 2015 paditësja ka realizuar pagë mujore prej 424.13, ndërsa për muajin Prill 2015 paditësja ka realizuar pagë mujore prej 477.34, andaj gjykata mori për bazë mesataren e tri pagave të fundit, ku shihet qartë se pagamesatare ka qene ajo që përmendet më lartë.

Gjykata për vendosje sipas pikës I të dispozitivit sa i përket pagesës së tri pagave në emër të shpërblimit jubilar iu referua nenit 36 par 9 nën par. 9.3 dhe 9.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të Kosovës me të cilën parashihet se "punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit t'i njihet e drejta në shpërblim jubilar në vlerë-lartësia të tri pagave mujore të tij, ndërsa gjykata me rastin e vendosjes në emër të kompensimit për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension u bazua në nenin 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të Kosovës me të cilën parashihet e drejta e punëmarrësit paditësit me pagesën përcjellëse të tri pagave mujore që i ka marrë në tre muajt fundit.

Bazuar në nenin 36 par.9.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të Kosovës është detyrim i punëdhënësit të fundit këtu të paditurës që t'i paguaj kompensimin për dy kategori të lartcekura.

Gjykata kur ka vendosur sipas pikës I të dispozitivit sa i përket pagesës së tri pagave në emër të shpërblimit jubilar, përveç Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të Kosovës, iu referua edhe nenit 52 par 1 nën par 1.3 të Marrëveshjes së përgjithshme kolektive të datës 18.03.2014, me të cilën parashihet se "punëmarrësi i cili për 30 vite radhazi dhe pandërprerë të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit t'i njihet e drejta në shpërblim jubilar në vlerë-lartësia të tri pagave mujore të tij, ndërsa gjykata me rastin e vendosjes në emër të kompensimit përpagesën e tri pagave përcjellëse për pension u bazua në nenin 53 të marrëveshjes kolektive me të cilën parashihet e drejta e punëmarrësit paditësit me pagesën përcjellëse të tri pagave mujore që i ka marrë në tre muajt fundit.

Gjykata, lidhur me përlllogaritjen e kamatës, u bazua në nenin 382 par 2 të LMD-se.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve 40 euro ne emër te taksës për padi, 104 euro për përpilimin e padisë, 135 euro për përfaqësim në seancë.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi ne nenin 143 par 1 te LPK-se.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.282/2018, datë 01.11.2018**

**GJYQTARI**  
**Faton Ademi**



**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundërkëtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi, Gjykatës se Apelit ne Prishtine. Ankesa ushtrohet përmeskësaj Gjykate.